

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Shërbim i mirëmbajtjes së mjeteve motorike në pronësi të OSSH sh.a, me afat 2 vjeçar”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Shërbime riparimi për automjete 50112110-7; Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash 50230000-6 - Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe shërbime të tjera të lidhura dhe pajisje të tjera

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave: 176,660,000 (nëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh, ose 1,817,863.75 (një milion e teteqind e shtatëdhjetë mijë e teteqind e gjashtëdhjetë e tre pike shtatëdhjetë e pesë) euro.

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 19/08/2025 është 97.18 Lekë/Euro.*

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga të ardhurat e OSSH sh.a

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes :

Bazuar në Nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur, siç është rasti i Shërbimit për mirëmbajtjen e mjeteve të OSSH sh.a. Gjithashtu kjo zgjedhje e marrëveshjes kuadër me 1 Operator ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për këtë procedurë prokurimi, është se objekti i prokurimit parashikon një shërbim periodik dhe të vazhdueshëm dhe për këtë arsye realizimi i shërbimit nga operatorë ekonomik të ndryshëm nuk është i favorshëm duke i shkaktuar vështirësi autoritetit kontraktor. Bazuar dhe në rekomandimet e APP-së, është përzgjedhur lloji i Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Kryerja e shërbimit të kërkuar nga AK nga operatorë të ndryshëm ekonomikë nuk do të ishte i favorshëm, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të shërbimit objekt prokurimi, për kryerjen e procedurave të minikonkurimit nga AK, palë e kësaj MK duke shkaktuar vështirësi në realizimin e shërbimit në rast vonese të ofrimit të shërbimit.

2. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të kryerjes së shërbimit. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për realizimin e shërbimit në kohën e kërkuar nga AK.

Marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre.

Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në realizimin e shërbimit duke rrezikuar dhe procesin e punës.

Me qëllim garantimin e kryerjes së shërbimit në afatet kohore të përcaktuara për AK përfitues MK me një OE të vetëm do të garantonte sigurinë e kryerjes së shërbimeve kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

3. Qëllimi i aplikimit të kësaj lloj marrëveshje kuadër është vendosja e kushteve të njëjta për lidhjen e kontratave, gjatë periudhës kohore të marrëveshjes kuadër. Për arsye teknike, realizmi i shërbimit të mirëmbajtjes së mjeteve nga operatorë ekonomikë të ndryshëm nuk është i favorshëm, pasi është më e favorshme nga ana teknike që shërbimet e domosdoshme për të njëjtin mjet të kryhen nga i njëjti operator ekonomik në mënyrë që autoritetit kontraktor të mos i shkaktohen vështirësi dhe kosto shtesë gjatë procesit të mirëmbajtjes pasi kjo mospërputhje do të krijonte vështirësi në realizimin e kontratës me sukses, nëse do të ofrohej shërbimi nga operatorë të ndryshëm ekonomikë.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Afati kohor i ofrimit të shërbimit është parashikuar për një periudhë kohore prej 2 (dy) vjet, duke nisur nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK, duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve në përdorim të OSSH sh.a

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe ne mbështetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojme Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepërjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar), nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, d** në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose...”, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Ky kriter vendoset mbështetur në Ligjin Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, neni 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, duke siguruar AK që shërbimet objekt prokurimi do të realizohen nga subjekte që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji. Liçenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të **tipit B, Kodi III.1.B**, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Shenim :

Nëse Operatori Ekonomik, nuk disponon ne pronesi ambient per repartin e bojatisjes por e siguron kete sherbim nepermjet kontrates se bashkepunimit, duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 6.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose..., si dhe Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, dhe referuar zërave të shërbimit objekt prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit konstatohet, se një ndër këto zëra është dhe shërbimi “Riparim, Stukime & lyerje mjetit” për automjetet për të cilat autoriteti kontraktor kërkon që të kryejë shërbimin vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponoj leje mjedisore për Veprimtari që përfshijnë përdorimin e solventëve/ Lyerja dhe lustrimi i makinave.

Kriteri kualifikues lidhur me disponueshmërinë e lejes mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, gjen mbështetje ligjore në pikën 7.12/g “Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve”, në gërmën “g” është parashikuar “Lyerja dhe lustrimi i makinave”, të Shtojca 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, pasi referuar shërbimeve të parashikuara në specifikimet teknike është parashikuar zëri i shërbimit “Riparim, Stukime & lyerje mjetit”. Dispozitat ligjore më sipër kanë përcaktuar detyrimin e operatorëve ekonomikë që kryejnë veprimtarinë e lyerjes dhe lustrimit të makinave që të pajisjen me këtë lloj leje mjedisore për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së parashikuar të kontratës**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 2 (c) konkretisht: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë 41. Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 43 Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 46 intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme;”

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në

mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar **(të vitit 2025)** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

.

*** Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/et lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën përkatëse të DST.

Argumentimi: AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 43 pika 2/a të VKM Nr 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar .

Gjithashtu në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 39% të vlerës së fondit** limit të kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kriteri i vendosur është në përputhje me nenin 41, pika 3 të VKM së sipërcituar dhe garanton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, kanë realizuar kontrata të ngjashme me ente publike apo me sektorin privat dhe i kanë përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë. Vlera jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës, është vlerë e arsyeshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.2 Operatori ekonomik në pronësi/ose me qera pajisjet dhe instrumentet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës si më poshtë:

- mbi 8 (tetë) ura ngritese për automjetet (me kapacitet jo më pak se 3 Ton)
- 6 (gjashtë) ura ngritese për furgonat (me krah të gjatë) me kapacitet jo më pak se 4ton
- 2 gropa për mjetet e rënda (kamjona, autovinça, fadroma).
- 1 Linjë kontrolli për kamjona (kontroll sistemit frenimit, amortizimit, konvergences)
- 2 linja kontrolli teknik të paisur me ure perkatese për ngritje dhe kontroll të mjetit
- 2 (dy) pajisje diagnostikuese të defektit në automjet.
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit të automjetit
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit.
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe testimin e defekteve (xhokove) në sistemin e drejtimit.
- 2 pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit.
- 2 pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave automjetit (ballancim i rrotave).
- 2 pajisje të levizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v.
- 1 (një) pajisje bango prove për motorrine dhe dinamo
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C
- 1 (një) pajisje për rregullimin e ndricimit të automjeteve
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e gazrave të automjeteve
- 1 (një) pajisje për sistemin e kontrollit dhe dedektimin të rrjedhjes së sistemit të ftohjes të automjetit (Radiatori dhe Pjesëve perberese të tij)
- Pajisje për kontrollin në presion të testates dhe cilindrit të motorrit
- Pajisje për pastrimin nga brenda e motorrit me H2

- Pajisje per pastrim te partikularit dhe marmides katalitike (pastrimi DPF)
- 1 (nje) paisje per saldim me oksigjen dhe acitilen
- 1 (nje) paisje per saldim me argon
- 1 (nje) paisje per saldim me elektrik
- 2 (dy) paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit te kompletuara perkatesisht me urat me kater kollona te pershtatshme ne kapacitet per fuoristradat dhe furgonat sipas listes automjeteve referuar specifikimeve ne DT.
- Te kete repart te riparimit karrocerise se automjetit (shasise, tapicerise dhe perpunimit te llamarines) si dhe bojatisjes se mjetit te pajisur me :
 - a) 1(nje) furre per lyerje me kapacitet per mjetet fuoristrada dhe furgona
 - b) 1 (nje) furre per lyerje me kapacitet per kamjona, repartin per pergatitjen paraprake
 - c) 1 (një) pajisje per drejtim shasie te cilat te kene kapacitet ne pershtatje te plote per realizimin e sherbimeve te mjeteve sikurse kerkohet ne specifikimet teknike
 - d) Reparti te jete i kompletuar me pajisjet perkatese (pajisjes poter per drejtim llamarine, puntatrice, aparat saldimi, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi)

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: Dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi/ çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- Fotografi te pajisjeve te mesiperme te cilat kerkohen te jene te montuara ne servis si dhe te paraqiten kataloget/fragmente katalogu perkates te pajisjeve te cilat disponon aktualisht ne servis.

Lidhur me kerkesat e vendosura ne kete kriter kemi parasysh qe te gjitha pajisjet e kerkuara me siper, jane ne perputhje te plote me specifikimet teknike dhe ne funksion te shumëllojshmerise se zërave të riparimit dhe shërbimeve si dhe të sasisë së automjeteve të kërkuara në DT.

Kriteri 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, “..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi.

Duke vlerësuar proceset e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre paisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se oferteusit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara në Shtojcën 6 (Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se ka në dispozicion, apo mund t'i vihet në dispozicion, **minimalisht 2 (dy) karrotrec**, për transportimin e automjeteve të difektuara, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat:

a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë: Certifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes / Kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve rrugore.

e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Kriteri 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion të paktën një karrotrec për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se objekt i kësaj procedure prokurimi është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambjentet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë minimalisht, 2 (dy) automjete, konkretisht karrotrec me qëllim realizimin e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne pronesi ose me qera ne perdorim te ambjenteve per ushtrimin te aktivitetit te tij (lidhur me riparimin e automjeteve) ne zonat ku ndodhen Drejtorite perkatese te OSSH sha, TIRANE, SHKODER, KORÇË, FIER.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Operatorët ekonomikë për ambjentin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

- *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - Certifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
 - kontrata e shitblerjes; ose
 - kontrata e dhurimit; ose
 - çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
 - Kontratë huaje.
- *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - Kontratë qiraje.

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e hapësirave në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve per gjithë Shqiperine, të cilat duhet të dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, ne zonat ku ndodhen Drejtorite perkatese te OSSH sha, TIRANE, SHKODER, KORÇË, FIER.

Disponimi minimalisht i disa ambjenteve ne rajonet kryesore te OSSH sh.a ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

a) Standardin **ISO 9001:2015** ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Standardin **ISO 14001:2015** ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të mjedisit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) standardin **ISO 45001:2018** ose ekuivalent, (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë veçanërisht për sektorin e automobilave, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimit të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

ISO 45001:2018 ose ekuivalent, (e përditësuar) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të bëhet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve, duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës, objekt prokurimi.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e shërbimit.

2.3.6 a. Operatorët ekonomikë duhet të ketë të punësuar në stafin e tij jo më pak se 22(njezet e dy) punonjës, të nevojshëm për realizimin e kontratës, për muajin e fundit të deklaruar. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë stafin sipas profileve/ profesioneve të mëposhtme:

- 7 (shtate) xhenerike
- 2 (dy) motorriste
- 1 (një) pompist
- 2 (dy) elektroauto
- 2 (dy) bojaxhi/llamarinist
- 1 (një) saldator
- 2 (dy) gomiste

Për punonjësit, me profesion si më sipër, duhet të paraqiten:

- CV, certifikimin profesional
- kontratë pune (të vlefshme) të noterizuar

b. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- (dy) Inxhinier **mekanik/ teknik/ mekanik transporti**, në detyrën/rolin e drejtuesit teknik.
- inxhinier mekatronik diagnostikues difektesh elektrike, elektronike si dhe te sistemit injeksionit te ushqimit ne motorr per automjetet

Për punonjësit, me profesion si më sipër, duhet të paraqiten:

- diploma e arsimit të lartë i profilit inxhinier
- kontratë pune (të vlefshme)
- ✓ Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë me kohë të plotë pune pranë operatorit ekonomik.

c. te pakten 2 (dy) shofere

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, *Deshmi Aftesie Profesionale te vlefshme (leshuar nga institucionet perkatese)*, Librezë pune .

(Në rastin kur punonjësit /shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)

Në lidhje me punonjësit sa më sipër të germës a. dhe b., duhet të paraqiten listëpagesat e sigurimeve shoqërore të dorëzuara në organet tatimore, për periudhën muajin e fundit te deklaruar, ku punonjësit me profesionet e kërkuara më sipër të jenë detyrimisht të pasqyruar në to.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT, nëpërmjet deklaramit nga OE të personelit teknik/ profilitin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërisë, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit, lysterje, saldime etj është e nevojshme disponimi i një stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë,

elektroaut, bojaxhi, sadator etj, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/fragment katalogun e prodhuesit/prodhuesve apo distributorit të autorizuar si dhe skemat origjinale të montimit për pjesët e kembimit që do të montohen gjatë riparimit për mallrat e paraqitura në Tabelën (Specifikimeve teknike Shtojca 5) bashkelidhur DT.

Tabelat e Artikujve/mallrave të kërkuara të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 5 (Specifikimet teknike) në DT duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë zerat e riparimit që kërkohen në këtë tabelë. Në këtë tabelë nga ofertuesi duhet të plotësohet emri i kompanisë prodhuese/ose distributorit të autorizuar, emertimi i katalogut të artikullit/produktit, nr. i faqes së këtij katalogu si dhe kodin origjinal të pjesës së kembimit që do të montohet gjatë riparimit të mjetit.

Argumentimi: Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit/ve ose distributoreve të autorizuar me të cilët bashkepunon për të gjithë artikujt/mallrat objekt i këtij prokurimi. Në rastin e paraqitjes së Autorizimit të distributoreve, duhet të vertetohet me dokumentat që lidhen me midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve distributoreve si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat që do të furnizohen janë të reja dhe kanë garanci që lidhet me 6 muaj për shërbimet periodike dhe 12 muaj për çdo të tjetër.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me garanci nga prodhuesi dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.10 Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softwerike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar); Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Titullarit të Drejtorise Rajonale Tiranë Nr.2725 Prot., datë 11.08.2025, ne baze të korespondencës elektronike me OSSH Qender date 15.08.2025 vendosi që si reference për të gjitha të dhenat e procedurës me objekt: “**Sherbim i mirmbajtjes së mjeteve motorike në pronesi të OSSH sh.a, me afat 2 vjeçar**” të perdoret kontrata e meparshme me Nr. 2310/18 Prot., date 25.10.2023 si për listën e mjeteve, sasitë e preventivuar dhe specifikimet teknike.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara, termave të referencës, listës së mjeteve, marre nga kontrata e meparshme, Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për mirëmbajtje/ riparim mjeteve dhe cmimeve të ofertes fituese të kontratës së meparshme, përlllogaritit fondin limit të kontratës konform legjislacionit në fuqi për realizimin e objektit “ **Sherbim i**

mirëmbajtjes se mjeteve motorike ne pronesi te OSSH sh.a, me afat 2 vjecar”

Nevoja për riparim, mirëmbajtje të mjeteve, është parashikuar për 174 automjete.

Specifikimet teknike

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

“Shërbim i mirëmbajtjes se mjeteve motorike ne pronesi te OSSH sh.a, me afat 2 vjecar”

Kërkesat teknike:

- Numri i automjeteve motorrike që do të jenë objekt shërbimi mirëmbajtjeje është 174 copë.
- Mjetet motorrike janë prodhim i viteve dhe modeleve të ndryshme (sipas preventivit bashkëlidhur).
- Mjetet motorrike për nga lloji i karburantit që përdorin janë me naftë, benzinë.
- Në preventiv parashikohen: difekte të konstatuara, mundësia e difektimit gjatë periudhës nga data e nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të afatit 2 vjeçar dhe shërbime të tjera të domosdoshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre.
- Pagesat, për shërbimet që do të kryhen nga operatori ekonomik fitues i prokurimit do të bëhen vetëm mbi bazën e autorizimit për riparim, akt-difektimit, urdhërit të punës dhe faturës tatimore për secilin mjet.
- Pjesët e këmbimit të jenë të reja, teknikisht sipas standardeve të BE-së dhe të ambalazhuara.
- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve nga ana e Operatorit Ekonomik, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim.
- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes pa pagesë të shërbimeve të riparimit/ mirëmbajtjes që rezultojnë jo sipas kushteve teknike dhe afateve të garancisë, të përcaktuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike, sipas afateve të kryerjes së shërbimit.
- Sipas sasisë dhe emërimit të pjesëve të këmbimit të përshkruar për çdo mjet në preventiv si dhe konform specifikimeve teknike të përshkruara, Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, pranë servisit të autorizuar, nëpërmjet shërbimit me karrotrec dhe pa pagesë shtesë.
- Furnizimi i pjesëve të këmbimit dhe riparimi i automjeteve do të kryhet rast pas rasti sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor gjatë një periudhe 2 (dy) vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes kuadër për një periudhë kohore dy vjet, sipas kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor.

- Kontraktori do të paguajë me shpenzimet e tij procesin e rritimit të mjeteve pranë Autoritetit të certifikuar për kolaudimin teknik të tyre nëse rezultojnë të ngelin në këtë proces për arsye që kanë të bëjnë me realizimin e kësaj kontrate.
- Në rast difektimi dhe pamundësisë për të dërguar mjetin për riparim/ shërbim, operatori ekonomik duhet të ofrojë për mjetet e OSSH sh.a shërbim karroatreçi për transportimin e mjetit nga venddifektimi i mjetit në servisën e operatorit ekonomik për kryerjen e riparimit.

Afati i garancisë së Pajisjeve / Pjesëve të këmbimit:

- Pajisjet/ Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi i automjetit ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi i automjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së pjesëve që do të zëvendësohen (jo më pak se një vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike.
- Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e çdo pjese të mjetit në rast difekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë 1 vjeçare nga dita e furnizim vendosjes së mallit.

Shërbime që kërkohen:

- 1) Riparime profilaktike (pjesët e ndërrimit që zëvendësohen me kohë përdorimi),
- 2) Riparime difektesh (zëvendësim pjesë ndërrimi të konsumuara),
- 3) Riparime të përgjithshme (kthimi në parametrat fillestar).

Afatet e ekzekutimit: do të jete nga momenti i nënshkrimit të kontratës/kontratave, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 24 (njëzet e katër) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër.

Afatet e kryerjes së shërbimit: Riparimi ose shërbimi i automjetit të bëhet brenda dites dhe për shërbime të veçanta edhe më i gjatë.

Specifikimet mbi shërbimet e kërkuara si më sipër (por jo vetëm) janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe mundëson që OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit.